



VAZHDON NGËRÇI INSTITUCIONAL, OPOZITA KËRKON KONSTITUIMIN E KUVENDIT, LV-ja MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN

FAQE 4-5



Kosova po përballet me ngërç institucional. Kuvendi ende nuk është konstituuar dhe partitë nuk kanë arritur marrëveshje për zgjedhjen e presidentit. Ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka bërë thirrje për dialog, por takimi i saj është

refuzuar nga PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca. Ani pse LV-ja kërkon marrëveshje për presidentin para konstituimit të Kuvendit, opozita insiston që Kuvendi të funksionalizohet menjëherë. Për zgjidhjen e krizës, Donika Gërvalla ka kërkuar dialog dhe

një president konsensual, ndërsa Aleanca ka ofruar shtatë votat e saj për presidentin në këmbim të plotësisht të gjashtë kërkesave. Në të njëjtën kohë PDK-ja ka vazhduar aksionet para qeverisë, duke kërkuar funksionalizimin e institucioneve

**KE-JA PËR
HAPJEN E URËS
MBI IBËR:
PRESIM
KOORDINIM DHE
KONSULTIME**

F. 3



**RAMA MBËSHTET
NISMËN E IKD-së:
KUSH KEQPËRDOR
PARATË
PUBLIKE DUHET
TË SHKOJË NË
BURG**

F. 3



AKTUALE



**TRUMPI: IRANI NUK MUND TË KETË
ARMË BËRTHAMORE**

F. 2

**NGA KOMUNAT TE SHTETI: KUSH DO
T'I ZOTËROJË PRONAT PUBLIKE?**

F. 7

**NË KOSOVË REGJISTROHEN 25
RASTE TË REJA ME FRUTH BREND
NJË JAVE**

F. 6

EKONOMI



**KEK-u DO TË EKSPORTOJË
THËNGJILL NË MAQEDONINË
E VERIUT NË VLERË DERI
NË 73.2 MILIONË EURO**

F. 8

**INPO-ja: 80 PËR QIND E
AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT
ISHIN PLANIFIKUAR DERI NË
QERSHOR, POR U INICIUAN
VETËM 15 PËR QIND**

F. 8

SPORT



**SHTYHET DERBI NDËRMJET DRITËS
DHE PRISHTINËS**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ARRESTIMET E PRODHUESVE TË DRONËVE NË RUSI NXJERRIN NË PAH AKUZAT PËR KORRUPSION GJATË LUFTËS

MOSKË, 18 GUSHT - Dy raste të profilit të lartë kundër figurave udhëheqëse të industrisë së dronëve në Rusi kanë vënë në pah pretendimet e blogerëve pro luftës se korrupsioni po minon përpjekjet e Moskës në luftën kundër Ukrainës.

Rasti më i fundit lidhet me arrestimin, më 8 gusht, të dy drejtorëve të kompanisë “Drone Solutions”. Arrestimet pasuan ndalimin në qershor të miliarderit Valery Kustov, një figurë e njohur në industrinë ruse të dronëve. Të dyja rastet lidhen me akuza për mashtrim. Në të dyja rastet dronët e zhvilluar nga kompanitë përkatëse ishin paraqitur më herët para presidentit rus Vladimir Putin si shembuj të inovacionit vendas.

Kompania “Drone Solutions” ia kishte paraqitur Putinit në prill produktin e saj, të quajtur Aist, që do të thotë “lejlek”. Sipas kompanisë, fluturakja pa pilot ishte projektuar për transportimin e furnizimeve mjekësore dhe mallrave të tjera.

Tashmë drejtuesit e kompanisë, Irakli Khazalia dhe Vyacheslav Barbarov, mund të përballen me deri në 10 vjet burgim për akuzat për mashtrim. Detajet e çështjes mbeten të paqarta, por pas arrestimeve drejtuesi i një kompanie rivale të dronëve reagoi publikisht ndaj këtij rasti. “Industria e aviacionit pa pilot në vendin tonë është plot me njerëz që nuk kanë përvojë në aviacion”, ka shkruar Dmitry Tretyakov, kompania e të cilit pretendon se ka zhvilluar dronët e parë rusë që funksionojnë me inteligjencë

artificiale. “Problemi kryesor është mungesa totale e profesionalizmit, gënjeshttrat dhe shtirja e atyre që janë në krye të kësaj industrie”, ka shtuar ai.

Rasti tjetër lidhet me Kustovin, i njohur më së shumti për prodhimin e majonezës. Në vitin 2023 ai kishte themeluar kompaninë “Transport of the Future” në Toljati, një qendër e prodhimit të automjeteve, rreth 800 kilometra në lindje të Moskës.

Në uebfaqen e kompanisë vazhdon të jetë e publikuar një fotografi e Putinit gjatë vizitës së tij në uzinë në janar të vitit 2025. Vizita ishte paraqitur si pjesë e një programi kombëtar për inovacionin në fushën e dronëve. “Deri në vitin 2030 Rusia duhet të bëhet një nga novatorët kryesorë teknologjike në botë në fushën e sistemeve ajrore pa pilot”, u kishte thënë Putini drejtuesve të industrisë gjatë vizitës.

Kompania e Kustovit dyshohet se blinte dronë nga Kina dhe më pas i paraqiste si produkte të veta. Ai është akuzuar për përvetësim të fondeve qeveritare të destinuara për kërkim dhe zhvillim, ndërsa edhe ndaj figurave të tjera të larta të kompanisë janë ngritur akuza. Prokurorët pretendojnë se dëmi ndaj buxhetit të shtetit arrin në 105 milionë dollarë.

Blogerët pro luftës ngrenë akuza për korrupsion

Blogerët rusë pro luftës kanë pretenduar se Kustov fitonte 83 mijë dollarë për secilin dron që blihej në Kinë dhe më pas ia



shiste Ministrisë së Mbrojtjes. “Luftëtarët më të mëdhenj kundër korrupsionit në Rusi sot janë blogerët pro luftës. Ata besojnë se Rusia po e humb luftën për shkak të korrupsionit”, ka thënë për “Current Time”, Ivan Filippov, gazetar rus në mërgim dhe kritik që analizon kanalet pro Kremlinit në “Telegram”. Megjithatë, ky qëndrim ndonjëherë ka pasur pasoja për të ashtuquajturit blogerë “Z”, disa prej të cilëve janë ndaluar pasi kanë raportuar për korrupsion brenda forcave të armatosura ose kanë kritikuar mënyrën se si po zhvillohet lufta. “Sa herë që ka një histori për korrupsionin, veçanërisht në ushtri, veçmas kur bëhet fjalë për prokurimet shtetërore që lidhen me çështjet e mbrojtjes dhe armatimet, kjo i tërbon ata”, ka thënë Filippov.

Teksa teknologjia e dronëve ka transformuar luftën, Rusia fillimisht kishte mbetur prapa Ukrainës sa iu përket kapaciteteve të fluturakeve pa pilot. Si kundërpërgjigje, Moska bleu mijëra njësi dhe teknologji nga Irani përpara se ta zhvillonte prodhimin vendas. Dronët rusë tashmë sulmojnë rregullisht qytetet ukrainase, ndërsa njësi rus “Rubicon”, që zhvillon dhe siguron teknologji të reja, ka shkaktuar dëme të mëdha ndaj forcave ukrainase. Megjithatë, Ukraina duket se vazhdon të ketë avantazh teknologjik, çështje që është vënë në pah edhe nga komentatorët pro luftës në Rusi. Filippov ka përmendur Aleksei Chadayev, i cili ka komentuar rastin e Kustovit në kanalën e tij në Telegram. Chadayev ka vënë në pah se kompania e Kustovit ishte përpjekur, por kishte

dështuar, të zhvillonte një ekuivalent rus të dronëve ukrainas “Vampire”, të njohur nga ushtarët rusë edhe si “Baba Yaga”, sipas emrit të një figure mitike sllave.

Sipas Ministrisë së Mbrojtjes së Ukrainës, dronët “Vampire” mund të mbajnë një ngarkesë prej 15 kilogramësh deri në një distancë prej 20 kilometrash dhe kanë rezistencë të lartë ndaj luftës elektronike, si dhe kamera për operacione ditore dhe të natës. “Nëse droni do të kishte fluturuar mirë, ushtria ruse do të kishte pasur Baba Yagan e saj, të prodhuar në masë. Por, ai nuk fluturoi”, ka shkruar Chadayev.

Edhe ministri rus i Mbrojtjes, Andrei Belousov, ka dhënë një vlerësim negativ për këtë dron. Ai i kishte thënë Putinit gjatë një takimi në qershor se bëhej fjalë për “një produkt me cilësi jo shumë të lartë”.

TRUMPI: IRANI NUK MUND TË KETË ARMË BËRTHAMORE



UASHINGTON, 18 GUSHT - Presidenti amerikan Donald Trump ka ripërsëritur se synimi kryesor i Shteteve të Bashkuara ndaj Iranit mbetet pengimi i Teheranit që të zhvillojë ose të zotërojë armë bërthamore. “Qëllimi numër një është dhe do të jetë gjithmonë që Irani të mos mund të ketë, në asnjë mënyrë, formë apo rrethanë, një armë bërthamore”, ka shkruar Trumpi në një postim në platformën e tij, “Truth Social”. Deklarata e tij vjen në përfundim të afatit 60-ditor të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar mes Uashingtonit dhe Teheranit më 17 qershor, i cili synonte zhvillimin e mëtejshëm të bisedimeve për arritjen e një

marrëveshjeje më të gjerë. Irani ka insistuar vazhdimisht se programi i tij bërthamor ka qëllime civile dhe se nuk synon të zhvillojë armë bërthamore. Megjithatë, ShBA-ja dhe Irani nuk kanë arritur një marrëveshje për programin bërthamor të Teheranit brenda afatit të dakorduar prej 60 ditësh. Ndërkohë, qëllimi fillestar i memorandumit, hapja e Ngushticës së Hormuzit, nuk është realizuar. Që nga nisja e sulmeve të ShBA-së dhe Izraelit kundër Iranit në fund të shkurtit, Teherani ka bllokuar kalimin e sigurt përmes ngushticës së Hormuzit, një prej rrugëve më të rëndësishme për furnizimin global me naftë dhe gaz.

KASTRATI: NË INSTITUCIONET QENDRORE DUHET TË KETË CERTIFIKATA TË SIGURISË NË NIVELIN MË TË LARTË

PRISHTINË, 18 GUSHT - Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, ka kërkuar që zyrtarët dhe punonjësit që shërbejnë në institucionet më të rëndësishme të shtetit, përfshirë Presidencën dhe Kryeministrinë, të pajisen me certifikata të sigurisë të nivelit më të lartë.

Duke komentuar rastet e dyshuara të spiunazhit në Kosovë, Kastrati ka thënë se personat me qasje në informacione të ndjeshme shtetërore duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të rrepta të sigurisë. “Çdo oficer, çdo punonjësi që punon në Presidencë, në Kryeministri, në vendet që janë me rëndësi të

veçantë të shtetit, duhet ta kenë certifikatën e sigurisë”, ka deklaruar Kastrati në “Five” të “Dukagjinit”. Ai ka pretenduar se një person i dyshuar për spiunazh, i cili kishte punuar në Presidencë dhe Kryeministri, kishte pasur qasje në dokumente sekrete për rreth dy vjet. Sipas Kastratit, një qasje e tillë mund të ketë krijuar mundësi për nxjerrjen e informacioneve të ndjeshme, përfshirë dokumente, politika dhe strategji shtetërore.

Kastrati ka ngritur gjithashtu pretendimin se persona të dyshuar për spiunazh mund të jenë të pranishëm në nivele të ndryshme të institucioneve të Kosovës. “Fatkeqësisht, sipas mendimit tim, spiun ka në të



gjitha nivelet, prej nivelit politik, nivelit më të lartë shtetëror, nivelit operativ të mesëm dhe nivelit taktik”, ka thënë ai. Ai e ka përgëzuar Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë për arrestimet e personave të

dyshuar për spiunazh, duke kërkuar që hetimet të shtrihen edhe te kontaktet dhe rrjetet e mundshme të tyre. “Pasi i kanë kapur ata, duhet t'i zbulojnë se me kë kanë pasur kontakte dhe kush janë ata spiunë që janë

duke punuar”, është shprehur Kastrati.

Ish-komandanti i FSK-së ka kërkuar edhe më shumë mbështetje financiare dhe profesionale për institucionet e inteligjencës dhe sigurisë, duke theksuar nevojën që ato të veprojnë pa ndikim politik. “Duhet të kenë financim më shumë, duhet të kenë mbështetje më shumë dhe duhet të kenë njerëz e profesionistë që ata të mos preken nga politika”, ka deklaruar ai.

Në fund, Kastrati ka bërë thirrje për ndarjen e politikës nga strukturat e sigurisë. “Larg duhet të jetë politika nga uniforma”, ka përfunduar Kastrati.

KE-ja PËR HAPJEN E URËS MBI IBËR: PRESIM KOORDINIM DHE KONSULTIME

BRUKSEL, 18 GUSHT - Komisioni Evropian (KE) ka deklaruar se pret “koordinim efektiv dhe konsultime kuptimplota ndërmjet komunave të prekura dhe institucioneve qendrore të Kosovës” për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër, e cila lidh Mitrovicën e Jugut me atë të Veriut.

Zëdhënësja e KE-së, Anita Hipper, ka thënë në një konferencë për medie më 18 gusht, se qëndrimi i Bashkimit Evropian (BE) për urën mbetet i qartë. “Ajo që kërkojmë, gjithashtu, është që Policia e Kosovës të garantojë sigurinë e të gjitha komuniteteve, në përputhje me parimet demokratike, të drejtat e njeriut



dhe sundimin e ligjit, në mënyrë që të gjithë të ndihen të sigurt”, ka deklaruar Hipper. Duke folur për gjendjen aktuale, ajo ka rikujtuar se ura është e hapur për këmbësorë, por jo

ende për qarkullimin e automjeteve. “Ne e kemi bërë vlerësimin tonë, janë ndërmarrë hapa në këtë drejtim dhe qëndrimi ynë mbetet se ende presim koordinim efektiv dhe

konsultime kuptimplota, të cilat duhet të përmirësohen”, ka thënë Hipper.

Deklarata e saj vjen pasi misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka njoftuar më 10 gusht se ka nisur “tranzicionin gradual” të pranisë së tij të përhershme në urë. KFOR-i ka thënë se vendimi lidhet me përmirësimin e situatës së sigurisë dhe se procesi do të jetë gradual dhe në varësi të kushteve. Megjithatë, misioni do të vazhdojë të mbajë prani të dukshme në Mitrovicën e Jugut dhe të Veriut, si dhe në veri të Kosovës në përgjithësi.

Ura kryesore mbi Ibër ishte bllokuar pas luftës së vitit 1999 dhe, ndër vite, ka qenë një nga pikat kryesore të tensioneve

etnike.

Kosova dhe Serbia janë pajtuar për hapjen e urës në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. Sipas planit të zbatimit, të dakorduar më 2016, ura duhej të hapej për trafik në janar të vitit 2017.

Punimet për revitalizimin e saj, në të cilat janë investuar rreth 1.5 milion euro, kanë përfunduar në vitin 2018. Megjithatë, ura nuk është hapur asnjëherë për automjete.

Në vitin 2024 përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për hapjen e saj kanë nxitur kundërshtime nga serbët lokalë dhe kërkesa nga bashkësia ndërkombëtare që çdo veprim të bëhet përmes koordinimit.

RAMA MBËSHTET NISMËN E IKD-së: KUSH KEQPËRDOR PARATË PUBLIKE DUHET TË SHKOJË NË BURG

PRISHTINË, 18 GUSHT - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, i është bashkuar nismës legislative qytetare të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) për ndryshimin e Kodit Penal, duke e cilësuar atë hap të rëndësishëm drejt forcimit të demokracisë dhe qytetarisë aktive.

Rama ka bërë thirrje për respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe ligjeve në fuqi, duke theksuar nevojën që personat që keqpërdorin fondet publike të mbajnë përgjegjësi para drejtësisë. “Demokracia po fillon me qytetarizëm aktiv. Ju përgëzoj për këtë nismë, nismë me të cilën tregojnë që populli ynë, në njëfarë mënyre edhe ka filluar një vetëdijësim edhe më të qartë, të jetë në nivelin shoqëror, ku edhe kërkon përgjegjësi nga institucionet, kërkon përgjegjësi nga

politikanët, kërkon përgjegjësi nga secili qytetar që të respektohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese, pra që të respektohet ligji në fuqi, që të respektohet faktikisht shteti”, ka thënë Rama. Sipas tij, mosrespektimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nënkupton mosrespektim të shtetit. “Sepse person, kushdo që ata janë, nëse nuk e respektojnë... nëse nuk i respektojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në njëfarë mënyre nuk po e respektojnë as shtetin”, ka thënë ai.

Rama ka përmendur edhe rastet kur fondet publike, sipas tij, janë përdorur për interesa partiake. “Po ashtu, edhe ata të cilët partitë apo personat të cilët i kanë keqpërdorur ligjin apo i kanë i kanë keqpërdorur fondet publike për nevojat e veta partiake, pra siç ka ndodhur edhe në dhjetor, edhe



tash në qershor, ku paratë publike janë përdorur në njëfarë mënyre për me i blerë votat këto janë gjëra të jashtëligjshme për të cilat edhe duhet me u përgjigjur para Gjykatës Kushtetuese, pra duhet njerëzit me shku në burg nëse i kanë keqpërdorur paratë publike”, ka thënë Rama.

Ai ka theksuar se shoqëria duhet t'i shtyjë përpara këto çështje në mënyrë që vendimet e Gjykatës Kushtetuese të respektohen nga të gjithë. “Këto janë gjëra të cilat ne të gjithë si shoqëri pra duhet t'i shtyjme përpara, pra që vendimet e Gjykatës Kushtetuese të jenë të plotfuqishme dhe secili qytetar

t'i respektojë ato, përndryshe e rrezikojmë shtetin”, ka thënë ai. Rama ka treguar se për këtë arsye e ka nënshkruar peticionin dhe nismën legislative. “Kjo është edhe arsyeja pse unë jam sot këtu, e nënshkrova këtë petition, këtë nismë. Dhe i përgëzoj të gjithë qytetarët e Kryeqytetit dhe të gjithë Kosovës të cilët janë bërë pjesë e kësaj nisme”, ka thënë Rama.

Ai ka shprehur pritjen që së shpejti të mblidhen më shumë se 10 mijë nënshkrime. Uroj që së shpejti të kemi më shumë se 10 apo 12 mijë e më tepër, pra më shumë se 10 000 nënshkrime, ku edhe vendimet ose nënshkrimet e këtij peticioni pastaj të marrin hapat e veta dhe të bëhet pjesë e ligjit i cili edhe mundëson vendimet që kushdo që nuk e respekton ligjin, përfundon aty ku e meriton, në burg”, ka përfunduar Rama.

VAZHDON NGËRÇI INSTITUCIONAL, OPOZITA KËRKËN KONSTITUIMIN E KUVENDIT, LV-JA MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN



Kosova po përballet me ngërç institucional. Kuvendi ende nuk është konstituuar dhe partitë nuk kanë arritur marrëveshje për zgjedhjen e presidentit. Ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka bërë thirrje për dialog, por takimi i saj është refuzuar nga PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca. Ani pse LV-ja kërkon marrëveshje për presidentin para konstituimit të Kuvendit, opozita insiston që Kuvendi të funksionalizohet menjëherë. Për zgjidhjen e krizës, Donika Gërvalla ka kërkuar dialog dhe një president konsensual, ndërsa Aleanca ka ofruar shtatë votat e saj për presidentin në këmbim të plotësimit të gjashtë kërkesave. Në të njëjtën kohë PDK-ja ka vazhduar aksionet para qeverisë, duke kërkuar funksionalizimin e institucioneve

**EPOKA
ERE**
Lirim GECI

PRISHTINË, 18 GUSHT - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, njëkohësisht deputete e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) në Kuvendin e Kosovës, Albulena Haxhiu, ka paralajmëruar se partia e saj do të ketë “takim të shpejtë” me Lidhjen Demokratike të Kosovës në përpjekje për të arritur një marrëveshje për zgjedhjen e presidentit të ri të shtetit. Këtë deklaratë Haxhiu e ka bërë në një konferencë, pas një takimi që kishte thirrur me partitë politike parlamentare, siç ka thënë për t’u konsultuar në lidhje me daljen nga kriza politike “dhe shmangien e zgjedhjeve të parakohshme”. Thirrjen e saj e kanë refuzuar PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca, tri partitë më të mëdha parlamentare pas LV-së, e cila i ka fituar zgjedhjet e 7 qershorit. Sipas Haxhiut, në takim ishin 11 liderë të partive të tjera politike parlamentare, përfshirë ato të minoriteteve etnike. “Të gjitha

subjektet (e pranishme) ishin të qëndrimit që duhet të kontribuojmë maksimalisht në zgjedhjen e presidentit dhe shmangien e zgjedhjeve të parakohshme”, ka deklaruar Haxhiu. Teksa ka paralajmëruar takim të ri mes LV-së dhe LDK-së, ajo nuk ka saktësuar se kur do të ndodhë ai. Haxhiu ka bërë thirrje që të gjitha partitë “të flasin me emra të përvetshëm” për një president të mundshëm konsensual. Më herët LDK-ja kishte shprehur qëndrimin se nuk dëshiron marrëveshje politike për ta ndarë pushtetin në qeveri, por se është e hapur për të diskutuar për një “figurë konsensuale për president”. Ndonëse kanë kaluar më shumë se 30 ditë nga afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit të Kosovës pas zgjedhjeve, qëndrimi i partisë fituese të zgjedhjeve, LV-së, është që Kuvendi nuk duhet të konstituohet derisa të arrihet një marrëveshje për presidentin. Në anën tjetër, partitë që më herët ishin në opozitë e akuzojnë LV-në

për shkelje të Kushtetutës dhe për zvarritje të çështjes së konstituimit të Kuvendit, ndonëse i kanë numrat për ta bërë atë. “Nëse nuk mund të merremi vesh sot, nuk kemi asnjë garanci që një palë zgjedhje të reja mund të na bëjnë të merremi

vesh nesër”, ka deklaruar Haxhiu, duke arsyetuar vonesën në konstituimin e Kuvendit. Për takimin me disa nga liderët e partive politike, Haxhiu ka shkruar edhe në “Facebook”. Haxhiu ka deklaruar se, pavarësisht prej dallimeve politike, dialogu është i domosdoshëm për të gjetur një zgjidhje për situatën aktuale politike. Ajo ka theksuar se për zgjedhjen e presidentit nevojitet një marrëveshje më e gjerë politike dhe se kjo çështje nuk duhet të shtyhet deri në momentin e fundit. “Në takim u ritheksua qartë se vendit nuk i duhen zgjedhje të reja dhe se të gjitha palët kanë përgjegjësi të kontribuojnë në një marrëveshje

për një president konsensual”, ka shkruar Haxhiu. Sipas saj, kjo përgjegjësi është e përbashkët dhe nuk mund të shmanget apo t’u delegohet të tjerëve. Haxhiu ka kritikuar edhe refuzimin dhe bojkotimin e takimeve politike, duke deklaruar se një qasje e tillë nuk çon drejt një marrëveshjeje. “Refuzimi apo bojkoti i takimeve nuk është rrugë drejt marrëveshjes. Mospajtimi është legjitim, por shmangia e dialogut nuk zgjidh asgjë”, ka shkruar Haxhiu. Haxhiu ka bërë thirrje për më shumë përgjegjësi dhe dialog ndërmjet partive, duke theksuar se nuk është e nevojshme që palët të pajtohen paraprakisht për t’u ulur në tryezë. “Përgjegjësia për



zgjidhjen është e përbashkët, prandaj duhet përgjegjësi, dialog dhe një marrëveshje që i shërben interesit të përbashkët”, ka shkruar Haxhiu.

Kriza institucionale në Kosovë ka vazhduar pas zgjedhjeve të 7 qershorit, të cilat u mbajtën pasi partitë nuk arritën të gjenin marrëveshje për zgjedhjen e presidentit, pas përfundimit të mandatit pesëvjeçar të Vjosa Osmanit në krye të shtetit.

LV-ja ka fituar 53 vende në Kuvend, PDK-ja 22, LDK-ja 18 dhe AAK-ja shtatë. Për zgjedhjen e presidentit, Kushtetuta kërkon praninë e të paktën 80 deputetëve në sallë në dy raundet e para të votimit. Nëse presidenti nuk zgjidhet as në raundin e tretë, Kuvendi shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të reja.

PDK-ja dhe Aleanca insistojnë në konstituimin e Kuvendit

Rreth dy orë pas takimit të thirrur nga Haxhiu, të cilin e kanë refuzuar, deputetët e PDK-së dhe të Aleancës janë mbledhur në sallën e Kuvendit, duke kërkuar që të thirret vazhdimi i seancës konstituive. Kjo kërkesë është duke u bërë tash e disa ditë nga

shkaktuar nga partia së cilës qytetarët ia kanë dhënë përgjegjësinë për t’i konstituuar institucionet, por që në realitet ka vendosur ta mbajë krejt shtetin tonë peng. E pasojat i ndien pacienti që pret trajtim dhe mjeku që punon në kushte të vështira, i ndien polici, ushtari, zjarrfikësi që mbrojnë vendin, por vazhdojnë pa sigurim të mirëfilltë shëndetësor dhe jetësor. I ndien mësuesi, studenti që pyet a ka të ardhme këtu më, fermeri që pret mbështetjen e shtetit për të cilën ka shumë nevojë, biznesi që kërkon stabilitet për t’u zhvilluar. Ju, qytetarë të Republikës së Kosovës, po e paguani çmimin e një shteti që nuk po lejohet të funksionalizohet. E rreziku që po i kanoset Kosovës sonë dhe demokracisë që me aq shumë mund e sakrificë e kemi krijuar është shumë i madh. Demokracia nuk zhbëhet domosdoshmërisht brenda një nate. Ajo fillon të dobësohet kur një lider nuk i pranon më kufijtë që ia vendos Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kur Kuvendi mbahet jofunksional dhe s’ka mbikëqyrje, kur pushteti përqendrohet gjithnjë e më shumë dhe institucionet që duhet ta kontrollojnë atë dobësohen”, ka deklaruar Kabashi-Ramaj.



këto parti.

Deputetja e PDK-së, Besa Kabashi-Ramaj, ka reaguar lidhur me moskonstituimin e Kuvendit të Kosovës, duke deklaruar se vendi po vazhdon pa institucione të konstituara. Nga salla e Kuvendit ajo ka thënë se deputetët zgjidhen për të punuar dhe se asnjë fitore zgjedhore nuk i jep të drejtën asnjë partie të vendosë mbi Kushtetutën e Kosovës. “Edhe sot nuk është thirrur seanca për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Edhe sot Kosova vazhdon pa institucione të konstituara. Kjo duhet të na alarmojë të gjithëve. Ne jemi zgjedhur për të punuar, por si deputetë, në vend që të jemi në seancë duke u marrë me problemet e qytetarëve, jemi duke kërkuar që shteti të funksionojë së pari. Asnjë fitore zgjedhore nuk i jep askujt të drejtën ta vendosë veten mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Asnjë lider nuk është mbi shtetin. Asnjë parti nuk është mbi Kosovën”, ka deklaruar ajo.

Kabashi-Ramaj ka deklaruar se ajo që është duke ndodhur në vend është krizë shtetërore e shkaktuar nga Lëvizja Vetëvendosje. “Ajo që po ndodh këtu është një krizë shtetërore e

Tahiri: Kurti e ka ndalur Kosovën, pa e bërë hapin e parë nuk mund ta bësh të dytin

Nënkryetari i Aleancës, Besnik Tahiri, ka kritikuar moskonstituimin e Kuvendit të Kosovës, duke e akuzuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, se po e pengon funksionalizimin e institucioneve. Tahiri ka deklaruar se deputetët e zgjedhur dhe të certifikuar duhet ta kryejnë detyrën e tyre dhe të marrin pjesë



PDK-JA VAZHDON AKSIONET PARA QEVERISË, RINIA DEMOKRATIKE KËRKON FUNKSIONALIZIMIN E INSTITUCIONEVE



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka vazhduar edhe të martën aksionin para objektit të Qeverisë së Kosovës në shenjë proteste ndaj mosvazhdimin të seancës konstituive të Kuvendit. Në aksion është përfshirë edhe Rinia Demokratike e Kosovës, e cila ka kërkuar funksionalizimin sa më të shpejtë të institucioneve.

Përfaqësuesi i Rinisë Demokratike të Kosovës, Resul Suma, ka deklaruar se të rinjtë nuk mund të qëndrojnë indiferentë përballë bllokadës institucionale, duke paralajmëruar se pasojat e saj mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të ardhmen e tyre. “Sot si i ri i këtij vendi jam bashkuar protestës para ndërtesës së

qeverisë, sepse nuk mund të qëndroj indiferent kur institucionet e vendit tim mbahen të bllokuara”, ka deklaruar Suma. Sipas tij, mosfunksionimi i institucioneve ndikon edhe në besimin e të rinjve për të ndërtuar të ardhmen në Kosovë. “Çdo ditë e institucioneve të bllokuara është edhe një arsye më shumë që një i ri ta humbë besimin dhe ta shohë largimin nga Kosova si të vetmen perspektivë”, ka deklaruar ai.

Suma ka ngritur edhe pyetjen se si mund t’u kërkohej të rinjve të respektojnë dhe të punojnë për shtetin, nëse institucionet e tij, sipas tij, nuk funksionojnë dhe u nënshtrohen interesave politike. Ai ka kërkuar që Kuvendi të

konstituohet dhe institucionet të funksionalizohen, duke bërë thirrje që interesat shtetërore të vendosen mbi ato partiake. “Nuk duam një Kosovë ku të rinjtë mendojnë vetëm se si të largohen. Duam një Kosovë ku institucionet funksionojnë dhe ku askush, pavarësisht sa pushtet ka, nuk mund të mbajë shtetin peng për interesa politike”, është shprehur Suma.

Në fund ai i ka bërë thirrje kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, që të marrë pjesë në procesin e konstituimit të Kuvendit. “Albin Kurti, ndaleni bllokadën! Ejani në Kuvend! Konstituojeni atë dhe hapini rrugë funksionimit të institucioneve”, ka deklaruar Suma.

në konstituimin e Kuvendit. “Konstituimi i Parlamentit të Republikës së Kosovës nuk lidhet me asgjë. E ka vetëm një kusht dhe ai kusht është neve që jemi zgjedhur deputetë, jemi certifikuar prej KQZ-së me na verifikuar mandatet”, ka deklaruar Tahiri.

Sipas tij, nuk ekziston asnjë kusht tjetër ligjor, kushtetues apo politik, që do ta pengonte themelimin e Kuvendit.

Tahiri e ka krahasuar moskonstituimin e Kuvendit me pamundësinë për t’i ndërmarrë hapat e tjerë institucionalë. “Moskonstituimi i këtij institucioni është sikur me dashur mos me bërë hapin e parë. E për pa e bërë hapin e parë nuk mundesh me e bërë as të dytin, as me e mbërritur 100-

metërshin, as me përfunduar maratonën”, është shprehur ai.

Tahiri e ka akuzuar Kurtin se po e mban Kosovën në ngërç institucional. “Albin Kurti sot e ka ndalur Kosovën mos me e bërë hapin e parë”, ka deklaruar Tahiri, duke shtuar se Aleanca është për konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e presidentit. Tahiri ka bërë të ditur se Aleanca është e gatshme t’i ofrojë shtatë votat e saj për zgjedhjen e presidentit, por në këmbim të miratimit të gjashtë kërkesave të saj. “Ne do t’i ofrojmë shtatë votat tona në shkëmbim jo të pjesëmarrjes në qeveri e as të ndonjë pozicioni tjetër, veçse të miratimit të 6 pikave”, ka deklaruar ai.

Sipas Tahirit, për këto kërkesa ende nuk ka pasur një deklarim zyrtar dhe ai i ka akuzuar partitë politike se kanë tentuar ta zhvendosin diskutimin drejt interesave politike. Në fund, Tahiri ka deklaruar se Aleanca nuk do të tërhiqet dhe nuk do t’i nënshtrohet, siç ka thënë ai, presionit për zgjedhje të reja. “27 dhjetori do të jetë humbja e tij më e madhe në këtë që ka pasur”, ka deklaruar Tahiri.

Gërvalla kërkon dialog politik për tejkalimin e ngërçit institucional

Ministria në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka bërë thirrje

për dialog dhe marrëveshje politike për tejkalimin e situatës aktuale institucionale në Kosovë. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Gërvalla u ka bërë thirrje liderëve politikë që të marrin pjesë në takimin e thirrur nga ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, për të diskutuar për gjetjen e një zgjidhjeje për situatën e krijuar. “Ejani në takim! Të flasim!”, ka shkruar Gërvalla, duke theksuar se në tavolinën e dialogut duhet të kërkohej një zgjidhje që i shërben funksionimit të shtetit. Sipas saj, të gjitha subjektet politike duhet të kontribuojnë përmes propozimit të emrave konkretë për një president konsensual. “Kosova nuk ka nevojë për një tjetër ngërç institucional. Ka nevojë për përgjegjësi politike, dialog dhe marrëveshje”, është shprehur Gërvalla.

Ajo ka vlerësuar se marrëveshja nuk duhet të shihet si dobësi politike, por si përgjegjësi shtetërore. Gërvalla ka theksuar se shmangia e një krize institucionale është detyrim i të gjitha subjekteve politike, duke kërkuar që interesi i Republikës të vendoset mbi interesat partiake.

Aktakuzë për vrasje të rëndë në Mitrovicë

MITROVICË, 18 GUSHT - Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë ndaj të pandehurit me inicialet A. S., për veprat penale “Vrasja e rëndë” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”. Sipas prokurorisë, ngjarja ka ndodhur

më 27 maj 2026, në rrugën “Adem Voca” në Mitrovicë, në banesën e viktimës E. I. Në aktakuzë thuhet se i pandehuri A. S. e ka privuar nga jeta viktimën në mënyrë tinëzake dhe mizore. Sipas përshkrimit të Prokurorisë, në momentin kur viktimia ia ka hapur derën, A. S. i ka folur, e ka përqaftuar dhe ia ka uruar festën e Kurban Bajramit.

Më pas, ai ka hyrë në kuzhinë dhe papritmas ka nxjerrë një armë të ftohtë, thikë, me të cilën e ka goditur viktimën në pjesën e përparme të qafës, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse. Viktimia ka ndërruar jetë para se të arrinte të dërgohej në spital. Sipas aktakuzës, pas këtij veprimi, i pandehuri i është drejtuar edhe të dëmtuarit S. I.,

me qëllim që ta privojë nga jeta. I dëmtuari ka arritur t'i shmangët goditjes në fytyrë, por është goditur në fytyrë, përkatësisht në hundë dhe buzë, duke pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin. Me rastin e ngritjes së aktakuzës, Prokuroria Themelore në Mitrovicë i ka kërkuar gjykatës



që A. S. të shpallet fajtor për veprat penale që i vihen në barrë dhe t'i shqiptohet dënim meritor, sipas ligjit.

NË KOSOVË REGJISTROHEN 25 RASTE TË REJA ME FRUTH BRENDË NJË JAVE

PRISHTINË, 18 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se vetëm gjatë javës së fundit në Kosovë janë regjistruar 25 raste të reja me fruth. Sipas IKShPK-së, nga 16 prilli deri më 17 gusht, në Kosovë janë konfirmuar gjithsej 137 raste me fruth. Për krahasim, gjatë periudhës 2021-2024 ishin regjistruar vetëm tri raste me fruth, të gjitha të importuara. Sipas të dhënave të IKShPK-së, numri më i madh i rasteve është regjistruar në Prishtinë, gjithsej 47. Instituti ka intensifikuar aktivitetet e vaksinimit në komunat me numrin më të lartë të rasteve, duke vaksinuar 276 fëmijë që nuk e kishin marrë me kohë, sipas kalendarit të rregullt

të vaksinimit, vaksinën MMR. “IKShPK-ja rekomandon që çdo person me simptoma të dyshimta të fruthit, si temperaturë e lartë, skuqe apo ndryshime në lëkurë, kollë, rrufë ose konjuktivit, të paraqitet menjëherë në institucionet më të afërta shëndetësore”, thuhet në njoftim, ku shtohet se vaksinimi është mënyra më efektive për parandalimin e sëmundjes. Fruthi është ndër sëmundjet më ngjitëse dhe transmetohet përmes ajrit. Epidemiologia e IKShPK-së, Edita Goranci, në podcastin “5 pyetje” të “Radios Evropa e Lirë” ka deklaruar se rikthimi i sëmundjes në Kosovë lidhet drejtpërdrejt me rënien e vaksinimit të fëmijëve me



vaksinën MMR. “Kur e kishim mbulueshmërinë mbi 95 për qind me vaksinën kundër fruthit, situata epidemiologjike ishte e qetë. Rastet paraqiten pikërisht ku ka fëmijë të pavaksinuar”, ka thënë Goranci.

Ajo ka deklaruar se doza e parë e vaksinës kundër fruthit mbron në 93 për qind të rasteve, ndërkohë e dyta në 97 për qind. “Është një ndër vaksinat më të sigurta”, ka theksuar ajo. Sipas Gorancit, një fëmijë i infektuar

infekton rreth 90 për qind të kontakteve që nuk janë të vaksinuara. “Virusi përhapet gjatë të folurit, kollitjes apo teshtitjes, dhe mund të qëndrojë deri në dy orë në ajër dhe në sipërfaqe”, ka shpjeguar Goranci. Temperatura, ethet, rrjedhja e hundëve, skuqja e syve dhe dhimbja e fytyrës janë ndër simptomat e para të fruthit, sipas saj. Fruthi mund të jetë vdekjeprurës. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, mbi 95 mijë njerëz kanë vdekur nga fruthi gjatë vitit 2024, shumica fëmijë nën moshën pesëvjeçare, megjithëse një vaksinë kundër kësaj sëmundjeje ishte në dispozicion.

TUMOR 3.5 KILOGRAMËSH HIQET ME SUKSES NGA KAVITETI TORAKAL I NJË 23-VJEÇARI NË QKUK



PRISHTINË, 18 GUSHT - Një tumor gjigant, me peshë 3.5 kilogramë dhe përmasa rreth 27 centimetra në gjatësi e 17 centimetra në gjerësi, është hequr me sukses nga kaviteti torakal i një pacienti 23-vjeçar në Klinikën e Kirurgjisë Torakale të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Sipas njoftimit të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), bëhet fjalë për një ndërhyrje të rrallë dhe jashtëzakonisht komplekse, e cila ka paraqitur sfida të veçantë për ekipin kirurgjik për shkak të përmasave të tumorit, lokalizimit dhe kompleksitetit të ndërhyrjes në kavitetin torakal. Operacioni është realizuar nga ekipi i specializuar i Klinikës së Kirurgjisë Torakale, nën udhëheqjen e drejtorit të klinikës, dr. Nazmi Kolgeci. Ndërhyrja është kryer në bashkëpunim me ekipin e anestezionit, të udhëhequr nga anesteziologu Dr. Qendrim

Morina, ndërsa në operacion kanë marrë pjesë edhe instrumentarë dhe infermierë. ShSKUK-ja e ka cilësuar rastin si dëshmi të kapaciteteve profesionale dhe të bashkëpunimit multidisiplinar në trajtimin e rasteve komplekse kirurgjikale. “Ky sukses i radhës dëshmon edhe një herë përkushtimin e lartë, profesionalizmin dhe bashkëpunimin e shkëlqyer multidisiplinar të stafit të QKUK-së në trajtimin e suksesshëm të rasteve më të rënda dhe më komplekse kirurgjikale”, ka njoftuar ShSKUK-ja. Nga ShSKUK-ja kanë theksuar se “puna e ekipore, profesionalizmi dhe përkushtimi maksimal ndaj pacientit mbeten themeli i çdo suksesi” në institucionet shëndetësore. Ndërhyrja është përfunduar me sukses, ndërsa ShSKUK-ja nuk ka dhënë detaje të mëtejshme për gjendjen shëndetësore të pacientit pas operacionit.

Rritet numri i shtatzënive nga IVF-ja në QKUK, konfirmohet edhe një rast i ri

PRISHTINË, 18 GUSHT - Numri i shtatzënive të arritura përmes procedurave të fertilizimit të asistuar (IVF) në Klinikën e Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) po shënon

rritje. Të martën është konfirmuar edhe një shtatzëni e re, e arritur përmes procedurave të IVF-së në Klinikën e Gjinekologjisë. Lajmin për “Indeksonline” e ka konfirmuar drejtori i

Klinikës së Gjinekologjisë në QKUK, Zef Ndreaj. Ndërkohë, vetëm para disa ditësh, në këtë klinikë ishin konfirmuar edhe dy shtatzëni të tjera, të arritura përmes IVF-së. Këtyre rasteve u paraprin

edhe rasti i parë i shtatzënisë së konfirmuar përmes procedurave të IVF-së në QKUK, duke e çuar në rritje numrin e rasteve të suksesshme të trajtuara në Klinikën e Gjinekologjisë.



NGA KOMUNAT TE SHTETI: KUSH DO T’I ZOTËROJË PRONAT PUBLIKE?

PRISHTINË, 18 GUSHT - Ndërtesat e komunave, shkollat, qendrat mjekësore, palestrat, tokat, malet dhe prona të tjera, që aktualisht janë në pronësi të komunave të Kosovës, mund të kalojnë në pronësi të shtetit nëse miratohen ndryshimet e propozuara në Ligjin për Pronën Publike. Sipas një drafti fillestar të projektligjit, të siguruar nga “Radio Evropa e Lirë (REL)”, Republika e Kosovës do të ishte titullarja e vetme e së drejtës së pronësisë mbi pronën publike, ndërsa institucionet qendrore, komunat, kryeqyteti dhe ndërmarrjet publike do të ushtronin të drejta të shfrytëzimit, menaxhimit dhe administrimit të saj. Asociacioni i Komunave të Kosovës e ka konsideruar këtë ndryshim si tendencë për centralizimin e pronës publike dhe ka thënë se ai mund të ndryshojë rrënjësisht mënyrën se si komunat ushtrojnë të drejtat e tyre mbi pronën. Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka thënë se një ndryshim i tillë do t’i cenonte kompetencat dhe të drejtat e komunave mbi pronën publike. “Kjo do t’i zhvishte komunat nga çdo kompetencë dhe e drejtë e tyre”, ka thënë Totaj për “REL”-in. Ndryshimet në Ligjin për Pronën Publike, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2023, janë duke u trajtuar nga Ministria e Drejtësisë. Ligji aktual parasheh se institucionet qendrore dhe komunat mund të jenë bartëse të së drejtës së pronësisë mbi pronën publike. Por, sipas ndryshimeve që janë duke u përgatitur, prona publike trajtohet si pronë e Republikës së Kosovës. Ministria e Drejtësisë nuk i është përgjigjur interesimit të “REL”-it për të shpjeguar arsyet e ndryshimit të ligjit dhe nuk e bëri publik draftin e projektligjit. Megjithatë, Ministria konfirmoi se ka themeluar një grup punues për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pronën Publike. Në bazë të draftit fillestar, të cilin e ka siguruar REL-i, ndryshime janë propozuar në disa nene të ligjit.

Çfarë ndryshon me projektligjin?

Ndryshimi kryesor lidhet me atë se kush konsiderohet pronar i pronës publike. Ligji në fuqi e njeh mundësinë që prona publike të jetë e regjistruar në emër të njëjësive të vetëqeverisjes lokale. Projektligji i ri propozon që Republika e Kosovës të jetë titullare e vetme e së drejtës së pronësisë mbi pronën publike. Kjo do të nënkuptonte se komunat nuk do të ishin më pronare të pronës publike që e kanë aktualisht në pronësi, por

do të ushtronin të drejta të shfrytëzimit, menaxhimit dhe administrimit të saj. Ndryshime të propozuara ka edhe në mënyrën e bartjes së pronësisë, dhënies me qira, shfrytëzimit dhe këmbimit të pronave. Sipas ligjit aktual, me pronën publike në pronësi të Republikës së Kosovës administron Njësia për Administrimin e Pronës Publike, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Në projektligj parashihet që kjo njësi të zëvendësohet me Zyrën për Pronën Publike, e cila do të ishte përgjegjëse, ndër të tjera, për regjistrin e pronave publike. Kryetari i Prizrenit, Totaj, ka paralajmëruar se kalimi i pronësisë së pronave lokale te Republika e Kosovës do t’i kufizonte, sipas tij, komunat në zhvillimin ekonomik. Ai ka thënë se komunat do të kishin më pak hapësirë për të vendosur vetë për dhënie me qira, këmbimin apo përdorimin e pronave për projekte lokale. “Nëse nuk ka prona, pse duhet të ekzistojë komuna? Nuk do të mund të krijoheshin as të hyra vetjake”, ka thënë Totaj, duke theksuar se toka komunale është një nga instrumentet kryesore për zonat ekonomike, investimet dhe krijimin e vendeve të reja të punës. “Nëse do të dëshironim t’i jepnim një investitori tokë me qira, ne nuk do të mund të vendosnim më si pronarë, por do të duhej që qeveria të vendoste. Me këtë ligj do të prekej zhvillimi ekonomik”, është shprehur ai. Pikërisht për këtë çështje, të gjithë kryetarët e komunave të Kosovës kanë kundërshtuar, në mënyrë unanime, çdo përpjekje që komunave t’u hiqet pronësia mbi pronat e tyre, ka thënë Sazan Ibrahim, kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, në një prononcim për “REL”-in. “Kjo qasje cenon autonominë lokale”, ka thënë Ibrahim, duke theksuar se ndryshimet e propozuara, sipas tij, bien ndesh edhe me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe mund të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të komunave. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale ua njeh komunave të drejtën të posedojnë dhe të menaxhojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të shesin dhe të japin me qira pronën.



Komunat, gjithashtu, mbajnë regjistrin e pronës që kanë në shfrytëzim dhe posedim. Këtë e ka pohuar edhe Bekim Salihu, analist i politikave në Institutin për Studime të Avancuara - GAP, në Prishtinë. Ai ka thënë se komunat e Kosovës kanë kompetenca vetjake, të cilat u garantohen me ligjet përkatëse dhe me Kushtetutën e Kosovës. Njëra nga këto kompetenca lidhet edhe me menaxhimin e pronës. “Çfarëdo tendence për marrjen e kësaj të drejte cenon parimet ligjore dhe frymën e Kushtetutës së Kosovës”, ka thënë Salihu për “REL”-in. Sipas tij, Qeveria e Kosovës nuk mund ta ndryshojë bazën ligjore pa u konsultuar fillimisht me komunat.

Çfarë mund të nënkuptojë ndryshimi për komunat?

Asociacioni i Komunave ka paralajmëruar disa pasoja që, sipas tij, mund të rrjedhin nga ndryshimet e propozuara. Ndër to janë dobësimi i kontrollit të komunave mbi pronat që aktualisht i kanë në pronësi, kufizimi i mundësisë për përdorimin e tokës si instrument për zhvillim ekonomik lokal, rritja e pasigurisë për investitorët dhe vështirësitë e mundshme në këmbimin e pronave. Salihu i ka parë këto si probleme që mund të krijojnë pasoja zinxhirore. “Nëse komuna do të kishte nevojë për ndërtimin e një shkolle në pronën komunale, me ndryshimet ligjore, pëlqimin do të duhej ta merrte nga titullari i pronës - në këtë rast, Qeveria e Kosovës”, ka shpjeguar ai. “Kjo është e papranueshme dhe joligjore”, ka vlerësuar Salihu. Ministria e Drejtësisë nuk ka shpjeguar deri më tani arsyet për ndryshimin e konceptit të pronësisë publike, ndërsa drafti i projektligjit ende nuk është

publikuar zyrtarisht. Ai është në fazën e hartimit dhe pritet t’i nënshtrohet konsultimit ndërinstitutional dhe publik.

Komunat protestojnë më 1 shtator para qeverisë

Prishtinë, 18 gusht - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka njoftuar se komunat do të protestojnë më 1 shtator para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Vendimi është marrë të martën në takimin e Këshillit të Kryetarëve të Asociacionit të Komunave të Kosovës. “Sot, në takimin e Këshillit të Kryetarëve të Asociacionit të Komunave të Kosovës, u vendos që më 1 shtator 2026, në orën 11:00, të organizohet protestë në Sheshin “Skënderbeu”, përballë ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës”, është thënë në njoftimin e AKK-së. Sipas njoftimit, kryetarët e komunave janë dakorduar që përmes protestës të kërkojnë mbrojtjen e buxheteve, pronës dhe kompetencave komunale. Po ashtu, ata kërkojnë kompensimin e obligimeve që burojnë nga kontratat kolektive, zbatimin e normës së përvojës së punës prej 0.5 për qind nga buxheti i nivelit qendror, si dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet. Kryetarët e komunave kanë kërkuar gjithashtu financim të drejtë për komunat dhe ndalimin e ndërhyrjeve të nivelit qendror në autonominë lokale. Sipas AKK-së, protesta do të jetë paqësore, institucionale dhe jopartiake, në mbrojtje të interesave të komunave dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. “Më 1 shtator, Komunat e Kosovës e ngrënë zërin së bashku”, ka njoftuar AKK-ja. Edhe kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije

se kryetarët e komunave të Kosovës do të organizojnë protestë në shtator para qeverisë, në shenjë kundërshtimi ndaj asaj që e cilësojnë si bllokim të mjeteve dhe projekteve të pushtetit lokal. Rama ka thënë se kryetarët e komunave janë bashkuar kundër, siç e ka quajtur ai, “shkeljes së vazhdueshme të ligjit dhe qasjes totalitare të Qeverisë Kurti ndaj pushtetit lokal”. “Sot, të gjithë kryetarët e komunave jemi bashkë. Bashkë do të jemi edhe në shtator, në protestë para Qeverisë Kurti!”, ka shkruar Rama në “Facebook”. Sipas tij, paralajmërimi gjatë fushatës zgjedhore lokale se nuk do t’u ndahen mjete komunave që nuk qeverisen nga Lëvizja Vetëvendosje, tashmë është shndërruar në praktikë të bllokimit të mjeteve dhe pengimit të projekteve. “Paralajmërimi gjatë fushatës zgjedhore lokale se ‘nuk do t’u japim buxhet komunave që nuk qeverisen nga Vetëvendosje’, sot po materializohet në një praktikë të rrezikshme: bllokim të mjeteve, pengim të projekteve dhe ndëshkim financiar të komunave që nuk kontrollohen nga pushteti”, ka shkruar ai.

Rama ka pretenduar se, që nga viti 2022, komunave u janë marrë mbi 344 milionë euro për obligime që, sipas tij, nuk i kanë krijuar vetë. “Mbi 344 milionë euro u janë marrë komunave që nga viti 2022 për obligime që nuk i kanë krijuar vetë”, ka shkruar kryetari i Prishtinës. Ai ka thënë se bllokimi i mjeteve po pengon investimet dhe po synon, sipas tij, nënshtrimin e pushtetit lokal përmes presionit financiar dhe politik. Rama ka theksuar se komunat nuk duhet të trajtohen si pronë e kryetarëve, por si institucione që u përkasin qytetarëve. Rama ka akuzuar qeverinë se po i trajton komunat në mënyrë të ndryshme, në varësi të përkatësisë së tyre politike. “Kur qeveria bllokoi një komunë vetëm sepse nuk e qeveris Vetëvendosje, nuk po lufton një kryetar. Po ia mohon qytetarit një rrugë, një çerdhe, një shkollë apo një shërbim vetëm për shkak të mënyrës se si ai ka votuar”, ka shkruar Rama. Në fund, ai e ka cilësuar këtë qasje si diskriminuese dhe të rrezikshme për demokracinë.

LBK-ja KËRKON ZGJIDHJEN E NGËRÇIT INSTITUCIONAL DHE RIKTHIMIN E STABILITETIT POLITIK DHE EKONOMIK

PRISHTINË, 18 GUSHT - Lidhja e Bizneseve e Kosovës (LBK) ka shprehur shqetësimin e saj të thellë për zgjatjen e situatës së bllokimit institucional dhe për klimën e tensionuar politike e cila po krijon pasiguri të shtuar për qytetarët, bizneset dhe ekonominë e vendit.

Përmes një reagimi për medie, LBK-ja ka thënë se nuk ndërhyr në proceset politike, mirëpo qëndrimi i saj është i bazuar ekskluzivisht në interesin ekonomik dhe në nevojën që Kosova të ketë institucione funksionale, stabilitet institucional, sundim të ligjit, transparencë dhe parashikueshmëri për bizneset dhe investitorët. “Bizneset kanë nevojë për një mjedis ku vendimmarrja institucionale funksionon, politikat publike janë të qëndrueshme dhe reformat ekonomike mund të zbatohen pa pengesa të krijuara nga krizat institucionale. Zgjatja e kësaj situatë po rrezikon negativisht në besimin e investitorëve, në vendimmarrjen për investime të reja, në proceset e reformave ekonomike dhe në qasjen e vendit në mekanizma dhe programe të rëndësishme financiare



re ndërkombëtare”, është thënë në reagimin e LBK-së. Sipas LBK-së, gjendja ekonomike kërkon përgjegjësi institucionale. “Shqetësimi i komunitetit të biznesit bëhet edhe më i madh për shkak të gjendjes aktuale me të cilën po përballen ndërmarrjet në Kosovë. Prodhuesit vendorë, në veçanti, po përballen me një varg problemesh, sfidash dhe rreziqesh në forma të ndryshme, duke përfshirë rritjen e kostove, konkurrencën e produkteve të importuara, vështirësitë në treg, kostot e energjisë, mungesën e fuqisë punëtore dhe pasigurinë

që ndikon në planifikimin e investimeve. Në këto rrethana, bizneset nuk kanë nevojë për më shumë pasiguri. Ato kanë nevojë për stabilitet, vendimmarrje, reforma dhe politika ekonomike të qarta dhe të parashikueshme”, është thënë në reagim. Më tutje, LBK-ja ka vlerësuar se çdo vonesë institucionale ka kosto ekonomike. “Ajo ndikon në investimet e reja, në hapjen e vendeve të punës, në zhvillimin e prodhimit vendor dhe në aftësinë e kompanive për të planifikuar. Të dhënat tregojnë për shqetësime serioze sociale

dhe ekonomike. Sipas të gjeturave kryesore të hulumtimit nga inatirucionet kredibile të realizuar në maj 2026, situata sociale dhe ekonomike në Kosovë paraqet shqetësime që duhet të jenë në qendër të vëmendjes së institucioneve. 44 për qind e të rinjve të moshës 18-24 vjeç deklarojnë se mendojnë të largohen krejtësisht nga Kosova. Kostoja e jetesës paraqitet si një nga shqetësimet kryesore të qytetarëve, e lidhur me çmimet e mallrave të konsumit dhe energjisë elektrike. Këto të dhëna duhet të shërbejnë si një sinjal i qartë se fokusi institucional duhet të rikthehet te problemet konkrete të qytetarëve dhe ekonomisë”, është thënë në reagimin e LBK-së, duke shtuar se Kosova nuk mund të përballojë një krizë të zgjatur institucionale.

“Lidhja e Bizneseve të Kosovës konsideron se të gjitha subjektet dhe institucionet kanë përgjegjësi për tejkalimin e situatës aktuale dhe për krijimin e kushteve që proceset demokratike dhe institucionale të funksionojnë normalisht. Nuk është në interes të askujt që përplasjet politike të zgjaten

dhe të prodhojnë pasiguri ekonomike. Prandaj, LBK u bën thirrje të gjitha forcave politike që të ulin tensionet, të rikthehen në dialog institucional dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për funksionalizimin e plotë të institucioneve të Republikës së Kosovës. Interesi ekonomik i vendit duhet të jetë mbi çdo kalkulim afatshkurtër”, është thënë në reagimin e LBK-së, duke shtuar se Kosovës i duhet një ambient institucional ku bizneset mund të investojnë, prodhuesit mund të zhvillohen, punëtorët të kenë vende të sigurt pune, të rinjtë të shohin perspektivë në vend dhe investitorët vendorë e të huaj të kenë besim për të investuar. “Lidhja e Bizneseve të Kosovës mbetet e gatshme të kontribuojë në mënyrë profesionale dhe konstruktive në çdo proces që synon përmirësimin e klimës së biznesit, forcimin e ekonomisë dhe krijimin e një mjedisi më të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit privat. Sot më shumë se kurrë, Kosovës i duhet funksionalitet institucional, stabilitet ekonomik dhe një fokus i përbashkët te zhvillimi”, është thënë në reagimin e LBK-së.

INPO-ja: 80 PËR QIND E AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT ISHIN PLANIFIKUAR DERI NË QERSHOR, POR U INICIUAN VETËM 15 PËR QIND

PRISHTINË, 18 GUSHT - Mungesa e realizimit të planifikimeve të prokurimit publik po vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore për institucionet e Kosovës. Raporti i INPO-së, “Prokurimi që mbetet në plan”, tregon se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit kanë realizuar vetëm një pjesë të vogël të aktiviteteve të parapara. Nga 905 aktivitete të planifikuara për t'u iniciuar deri më 30 qershor, vetëm 170 janë iniciuar.

Hulumtuesi në INPO, Arbër Kabashi, ka prezantuar të dhënat e raportit për planifikimet dhe aktivitetet e prokurimit të ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit për periudhën nga 1 janari deri më 30 qershor 2026. Ai ka bërë me dije se analiza është bazuar në planifikimet e prokurimit të publikuara në platformën e e-Prokurimit dhe

në aktivitetet e iniciuara përmes formularit B55, përkatësisht njoftimit për kontratë. Sipas Kabashit, ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit kanë planifikuar gjithsej 1 128 aktivitete të prokurimit, me një vlerë totale prej rreth 600 milionë eurosh. Prej tyre, 905 aktivitete, me vlerë rreth 388 milionë euro, ishin planifikuar të inicioheshin deri më 30 qershor. Megjithatë, deri në fund të periudhës monitoruese janë iniciuar vetëm 170 aktivitete, ose rreth 15 për qind e tyre, me një vlerë totale prej rreth 31 milionë eurosh.

Kabashi ka vlerësuar se një nga sfidat kryesore për autoritetet kontraktuese gjatë këtij viti ka qenë miratimi me vonesë i buxhetit. Ai ka bërë të ditur se buxheti për vitin 2026 është publikuar në Gazetën Zyrtare më 2 mars, gjë që ka ndikuar në fillimin e procesit të hartimit dhe



dorëzimit të planifikimeve të prokurimit.

Ndërsa Osman Vishaj nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka vlerësuar se planifikimi i prokurimit është themeli i gjithë procesit dhe se niveli i ulët i realizimit nuk lë përshtypje të mirë. Sipas

tij, përveç vonesës në miratimin e buxhetit, edhe ndarja dhe riorganizimi i ministrive kanë krijuar vështirësi në planifikimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit. Edhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit është vlerësuar se niveli i realizimit të aktiviteteve

është i ulët në raport me planifikimet.

Beza Halilaj ka thënë se këto çështje nuk janë të reja dhe vazhdojnë të paraqiten në menaxhimin e parasë publike, duke kërkuar adresim të vazhdueshëm nga institucionet. Ndërsa ekspertja e prokurimit, Diana Metushi-Krasniqi, ka vlerësuar se problemi nuk lidhet vetëm me planifikimin, por edhe me mosrealizimin e reformave në fushën e prokurimit publik. Ajo ka theksuar se vonesat në realizimin e planifikimeve ndikojnë në shfrytëzimin e buxhetit, qarkullimin financiar në treg, funksionimin e bizneseve dhe performancën e institucioneve. Sipas saj, mosrealizimi i planifikimeve të prokurimit ndikon drejtpërdrejt edhe në përmbytjen e nevojave të qytetarëve dhe në besimin ndaj institucioneve.

KEK-u do të eksportojë thëngjill në Maqedoninë e Veriut në vlerë deri në 73.2 milionë euro

PRISHTINË, 18 GUSHT - Ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka njoftuar se Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) do të eksportojë thëngjill në Maqedoninë e Veriut për një periudhë trevjeçare. Sipas Rizvanollit, vlera e eksportit mund të arrijë deri në 73.2 milionë euro. Për herë të parë, kontrata është lidhur drejtpërdrejt ndërmjet dy kompanive publike, KEK dhe


ESM, pa ndërmjetësues. “Përgjatë 3 viteve, KEK-u do të eksportojë deri në 73.2 milionë euro thëngjill në Maqedoni të Veriut. Për herë të parë, kontrata është bërë mes dy kompanive publike, KEK dhe ESM. Çmimi prej 24.4 eurosh për tonë, pa TVSh, është shumëfish më i favorshëm për KEK-un në krahasim me kontratat e kaluara që bëheshin përmes ndërmjetësuesve. Për shembull, herën e fundit që

Kosova ka eksportuar në Maqedoni të Veriut, KEK-u e ka shitur thëngjillin në një tender të jashtëligjshëm me çmim prej vetëm 8 euro, duke përfshirë tantumën prej 3 eurosh dhe TVSh-në prej 18-përqindësh. Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë nuk ndikohet në asnjë mënyrë nga kjo kontratë, duke qenë se ESM është përgjegjëse për eskavimin dhe transportin e thëngjillit që do ta blejë”, ka njoftuar Rizvanolli.



‘INDIANA JONESI I VËRTETË’ QË GJETI NJË QYTET TË LASHTË E TË HUMBUR TË INKASVE

Në vitin 1911, një profesor amerikan pretendoi se thellë në Andet peruane kishte zbuluar fortesën e lashtë malore të mbretit të fundit inkas. Megjithatë, 53 vjet më vonë, një tjetër eksplorues vërtetoi se ai kishte gabuar - dhe, pak kohë më pas, një ekip i BBC-së ndoqi gjurmët e tij.



Gene Savoy (1927–2007) pozon përpara disa rrënojave (Getty Images)

Nga: Fiona MACDONALD (BBC)

“Askush tani nuk e vë në dyshim se ky ishte vendi ku ndodhej Vilcabamba e lashtë”. Kështu shkroi studiuesi i Jejlit [Yale] i cili në vitin 1911 i sollti rrënojat peruane të Maçu Piçus në vëmendjen e mbarë botës. Hiram Bingham III u angazhua nga banorët vendas për të kërkuar një qytet të humbur inkas, për të cilin legjendat thoshin se fshihte thesare - dhe ai ishte plotësisht i bindur se pikërisht atë kishte gjetur. Megjithatë, 50 vjet më vonë, bindja e Binghamit u vu në pikëpyetje nga një tjetër eksplorues amerikan, i mbiquajtur “Indiana Jonesi i vërtetë”. Në gusht të vitit 1964, Gene Savoy pretendoi se kishte gjetur të njëjtin qytet të humbur - rreth 60 kilometra (37 milje) në veriperëndim të Maçu Piçus. Ai besonte se ekspedita e tij kishte identifikuar fortesën malore të mbretit të fundit inkas në Espiritu Pampa (“Rrafshina e Shpirtrave”, ose Vilcabamba), një kompleks rrënojash në pyje të largëta malore të mbuluara nga retë, shumë lart mbi një degë të

Amazonës. Vetëm gjashtë javë pas zbulimit të Savoyt, një ekip i BBC-së ndoqi gjurmët e tij, duke udhëtuar me një gomone nëpër ujëra të rrëmbyeshme (ku edhe u përmbysën), duke u ngjitur me mushka në shpatet e thepisura të kanioneve dhe duke çarë rrugën përmes xhunglës deri te vendi i rrënojave. “Copëzat e informacionit që kishin mbledhur gjatë rrugës i bënë të dyshonin në disa prej pretendimeve të Savoyt”, tregoi prezantuesi. “Por, pasi kishin ardhur deri aty, duhej të vazhdonin dhe ta shihnin vetë”. Shumëçka ishte në lojë. Ndoshta do të gjenin “zemrën e një qyteti të panjohur, ku duket se ka të ngjarë që perandori i fundit inkas të ketë mbledhur mbetjet e popullit të tij”. Nga fillimi i shekullit XX, Vilcabamba (që do të thotë “rrafshinë e shenjtë” në gjuhën keçua, një gjuhë e lashtë indigjene) ishte shndërruar në një qytet legjendar, të rrënjësuar po aq në legjendë sa edhe në histori. Pasi nuk arriti t’i pengonte pushtuesit spanjollë të merrnin kryeqytetin e tij, Kuskon - në vitin 1536 - mbreti inkas Manko e udhëhoqi popullin e tij

të mundur drejt maleve përtej. Thuhej se disa mijëra prej tyre ndërtuan atje pallate dhe tempuj në kryeqytetin e Mankos në mërgim, ku kishte çuar thesaret prej ari, idhujt vezullues dhe mumiet e paraardhësve të tij. Sipas fratit të shekullit XVI, Martin de Murúa, i cili dokumentoi pushtimin spanjoll të Perusë, “në atë vend të largët, ose më saktë në atë tokë mërgimi, inkasit gëzonin pothuajse po aq luks, madhështi dhe shkëlqim sa në Cusko”. Përtej të qenit një vend mërgimi, Vilcabamba ishte gjithashtu një qendër e rezistencës inkase, ku planifikohej lufta guerile kundër spanjollëve dhe nxiteshin kryengritjet nëpër zona më të largëta. Megjithatë, në vitin 1572, përballë një pushtimi, inkasit i vunë zjarrin qytetit dhe u larguan. Kryeqyteti i fundit inkas u përpui nga xhungla dhe vendndodhja e tij mbeti mister për shekuj me radhë.

Në kërkim të qytetit të humbur legjendar

Binghami ishte angazhuar nga pronarë peruanë tokash në vitin

1909 për të zbuluar nëse një vend i njohur si Çokekirao (“djepi i arit”) ishte qyteti i humbur i legjendave. 34-vjeçari, i cili më vonë u bë senator amerikan, ishte profesor asistent i historisë së Amerikës Latine dhe rastësisht po udhëtonte në atë zonë. Ai nuk ishte arkeolog dhe as po kërkonte rrënoja inkase. Por, një zyrtar i pushtetit vendor, Juan José Núñez, prefekt i Apurimakut, nuk pranonte të merrte “jo”-në si përgjigje. “Núñezi këmbëngulte se, meqë isha doktor, me gradën PhD, duhej të dija gjithçka për arkeologjinë dhe mund t’i tregoja se sa i vlefshëm ishte Çokekirao si vend për thesare të groposura”, shkroi Binghami. “Kundërshtimi im se ai e kishte vlerësuar gabimisht nivelin e njohurive të mia arkeologjike u konsiderua prej tij thjesht si shenjë modestie”. Bingham më pas pranoi: “Dija shumë pak për inkasit”. Në vend të kësaj, ai u mbështet në një libër të botuar nga Shoqëria Mbretërore Gjeografike Britanike, me titull Hints to Travellers [Udhëzime për udhëtarët], i cili përmbante këshilla se çfarë duhej bërë kur ndesheshe me një lokacion

arkeologjik. Megjithëse ishte skeptik se në Çokekirao kishte ar apo se ai ishte qyteti i famshëm i humbur, udhëtimi megjithatë e frymëzoi Binghamin që, në vitin 1911, të drejtonte një ekspeditë të Jejlit për të gjetur strehën e fundit të inkasve. “Dukej se përtej vargmaleve shtrihej një rajon i panjohur, i cili mund të fshihte mundësi të mëdha. Ndoshta kryeqyteti i Mankos ishte i fshesur atje”, tha ai. Në fakt, udhërrëfyesit e kishin çuar Binghamin në lokacionin që Savoy do ta identifikonte 50 vjet më vonë, 150 kilometra në verilindje të Kuskos. Por, i penguar nga moti i keq, me rezervat ushqimore drejt fundit dhe me hamallët që kërcënonin se do ta braktisnin, ai u largua shpejt prej andej, përpara se të pretendonte se e kishte gjetur qytetin e humbur në Maçu Piçu.

Një tjetër eksplorues guximtar ndërmeret ekspeditën

Në vitin 1964, Savoy - një eksplorues 37-vjeçar nga Portlandi në Oregon - arriti në zonën pranë Espiritu Pampas, së


bashku me eksploruesin peruan Antonio Santander Cascelli. Fillimisht, vendasit refuzuan t'i udhëhiqnin drejt vendit, nga frika e një legjende fisnore sipas së cilës perënditë do t'i vrisnin ata që zbulonin vendndodhjen e tij. Pas shumë përpjekjesh për t'i bindur, peruanët i çuan Savoy dhe Santanderin te rrënojat e Vilcabambas, të mbuluara me myshk.

“Nuk u besonim syve”, tha Savoy. “Çdo ditë, bëhej edhe më e jashtëzakonshme”.

Savoy dhe Santanderi gjetën rrënoja të shpërndara në tri rrafshnalta malore, ku përfshiheshin një pallat, ndërtesa prej graniti dhe guri gëlqeror, si dhe shatërvanë - vetëm rrafshnalta e parë ishte afërsisht katër herë më e madhe se Maçu Piçu. Eksplorimi i zonës e çoi Savoy në përfundimin se “vendi ishte një strehë e përdorur nga inkasit e fundit, të përfshirë në agoninë e një lufte përfundimtare kundër pushtuesve të rinj”.

Megjithatë, vetëm pas dy javësh, udhërrëfyesit e tyre filluan të largoheshin, të frikësuar nga besëtytnitë fisnore. “Normalisht, ata ishin miqësorë dhe të buzëqeshur”, tha Savoy. “Por, kur i çuam në ato pyje, ndryshuan”. Ata vendosën të largoheshin dhe të ktheheshin më vonë për hulumtime të mëtejshme.

Vetëm gjashtë javë pas ekspeditës së tyre, një ekip i BBC-së përshkoi të njëjtën rrugë. “Për 400 vjet, pak evropianë kishin kaluar andej, e aq më pak dikush me një kamerë filmike”, shkroi



Hiram Bingham III (1875-1956)(Foto: Alamy)

Tony Morrison, regjisori i filmit të realizuar për serinë BBC Adventure nga David Attenborough. “Pas një jave ecjeje të mundimshme dhe një zbritjeje të gjatë në një pyll të dendur malor, shpesh të lagur

nga shiu, arritëm te rrënojat e vendbanimit inkas”. Xhungla e kishte mbrojtur qytetin për shekuj me radhë, ndërsa ata që përpiqeshin ta eksploronin duhej të çanin rrugën. Sipas një raporti, “pemë

të mëdha i kishin mbërthyer me rrënjët e tyre muret dhe tarracat, ndërsa degët e tyre ishin ndërthurur nga bimët kacavjerrëse po aq të trasha dhe të forta sa kabllot telefonike”.

“E urrej atë xhungël të mallkuar”, tha Savoy, por shtoi: “Më mirë do të vdisja atje sesa të mos eksploroja”.

Zbulimi i Savoyt dhe Santanderit nuk vërtetoi se rrënojat në Espiritu Pampa ishin kryeqyteti i fundit i inkasve. Por, diçka që ata gjetën atje do të çonte më pas në konfirmimin se bëhej fjalë për Vilcabamban - tjegullat e çatisë.

“Këto tjegulla janë deri tani prova më e fortë”, tha prezantuesi i BBC-së në vitin 1964. “Ata janë spanjolle për nga dizajni, por në ngjyrosje dhe shenja mbartin një ndikim të dallueshëm inkas”.

Rëndësia e tyre u njoh më vonë edhe nga John Hemmingu, drejtor i Shoqërisë Mbretërore Gjeografike në Londër nga viti 1975 deri më 1996 dhe ekspert i inkasve. Ai arriti të përputhte rrëfimet e dëshmitarëve okularë për Vilcabamban - përfshirë kronikat e fratit Martin de Murúa - me hollësitë e lokacionit.

Zbulimi i tjegullave ishte i pazakontë, pasi inkasit zakonisht përdornin kashtë për mbulimin e çative. Megjithatë, në përshkrimin që Murúa i bënte kryeqytetit inkas në mërgim, gjendej një e dhënë e rëndësishme: “Inkasit kishin një pallat në nivele të ndryshme, të mbuluar me tjegulla”.

Savoy tha më vonë: “Për ekzistencën e qytetit ishte folur

prej aq shumë kohësh, saqë ai pothuajse kishte kaluar nga historia në mit. Tani ne e kemi rikthyer në histori”. Pra, duket se në vitin 1911, Binghami kishte kaluar vetëm pak hapa larg vendit që po kërkonte - strehës së fundit të Perandorisë Inkase.

Megjithatë, për Savoyt mbetej ende një mister. “Vetëm një pjesë e vogël e arit dhe e xhevahireve të inkasve u gjet ndonjëherë”, i tha ai revistës Esquire në vitin 1967, “dhe, kam arsye të besoj se [ata] pjesën tjetër e hodhën në liqene dhe shpella, në vend që ta linin të binte në duart e spanjollëve. Në ekspeditat e mëparshme kam gjetur liqene që nuk figuronin në asnjë hartë dhe tunele të mbyllura me mur, të pashënuara në harta”.

Zbulimi i atij që duket se ka qenë qyteti i fundit inkas - edhe sot kryesisht i varrosur nën xhungël, me strukturat e tij prej guri të mbërthyer nga bimët dhe me rrënjët e pemëve që u zënë hyrjet - ka ngritur më shumë pyetje sesa ka dhënë përgjigje.

“Zona është magjepsëse, sepse ende nuk është cenuar apo plaçkitur”, i tha The Guardian-it në vitin 2018, Javier Fonseca, arkeolog në Ministrinë e Kulturës të Perusë. Madje, ka pasur edhe raportime për një qytet tjetër, më thellë në pyll.

“E dimë se i ashtuquajturi ‘thesari i humbur i inkasve’ nuk është gjetur”, tha Savoy në vitin 1967. “Nëse ky thesar ekziston ... atëherë mund të hamendësojmë se ku mund të ndodhet”. /Telegrafi/

PUSHIME MES KRIZASH, KU PO E KALOJNË VERËN LIDERËT EVROPIANË?

Europa ka hyrë në periudhën e pushimeve verore. Parlamente të mbyllura dhe zyrat e boshatisura u kanë dhënë liderëve evropianë mundësinë të largohen për pak ditë nga detyrat e tyre.

Por këtë verë, pushimet vijnë në një moment të vështirë. Lufta në Ukrainë, tensionet në Lindjen e Mesme, pasiguria ekonomike dhe zjarret që kanë përfshirë disa vende europiane vazhdojnë të jenë në qendër të vëmendjes. Për këtë arsye, liderët po përpiqen të gjejnë një ekuilibër mes pushimeve dhe detyrave zyrtare. Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen, nuk ka treguar se ku po i kalon pushimet. Ajo ka thënë se po kalon kohë me familjen, por vazhdon të jetë në kontakt me ekipin e saj në Bruksel. Von der Leyen është e njohur për qëndrimet në shtëpinë e familjes pranë Hanoverit, ku ka një fermë me kuaj, pula dhe dhi.

Pushimet e saj janë komentuar edhe më parë. Në vitin 2023, ajo kaloi disa ditë në pronën e kryeministrit grek Kyriakos Mitsotakis në Kretë. Zgjedhja shkaktoi kritika dhe më vonë Ombudsmani European e cilësoi rastin si një problem në rregullat e etikës së BE-së.



Emmanuel Macron

Presidenti francez Emmanuel Macron po pushon në Fort de Brégançon, rezidenca zyrtare e presidentit francez në Côte d'Azur, së bashku me bashkëshorten e tij, Brigitte Macron.

Macron është fotografuar duke përdorur një jet ski, pamje që ka sjellë kritika nga kundërshtarët e tij, të cilët e akuzojnë se është larg problemeve të përditshme të qytetarëve. Megjithatë, Presidenca franceze thotë se Macron vazhdon të punojë edhe gjatë pushimeve. Ai ka zhvilluar biseda telefonike me liderë të vendeve të ndryshme

dhe është informuar për situatën e zjarreve në Francë.

Pedro Sánchez

Kryeministri spanjoll Pedro Sánchez po qëndron në rezidencën zyrtare La Mareta, në Lanzarote. Pushimet e tij kanë përkuar me një situatë të tensionuar në Ceuta, ku në fund të korrikut hynë rreth 80 mijë migrantë. Sánchez ka ndërprerë disa herë pushimet për të zhvilluar takime dhe mbledhje online për situatën. Qeveria thotë se gjendja në Ceuta ende nuk është normalizuar plotësisht. Opozita spanjolle e ka kritikuar kryeministrin për

mënyrën se si po paraqitet situata, duke pretenduar se ai po përpiqet të krijojë një imazh normaliteti ndërsa kriza vazhdon.

Giorgia Meloni

Kryeministrja italiane Giorgia Meloni po i kalon pushimet në Puglia, në jug të Italisë, së bashku me vajzën e saj dhe motrën. Sipas mediave italiane, në një fermë pranë Brindisit mund t'i bashkohen edhe miq dhe bashkëpunëtorë të saj politikë. Puglia është një zonë e njohur për Melonin. Pikërisht aty ajo priti liderët e G7 në samitin e vitit 2024. Meloni pritet të përballet me një periudhë të rëndësishme politike

gjatë vitit të ardhshëm, ndërsa mbetet në garë për një mandat të gjatë në krye të qeverisë italiane.

Friedrich Merz

Kancelari gjerman Friedrich Merz po kalon një pushim të shkurtër në Gjermani me bashkëshorten e tij, Charlotte.

Kancelaria gjermane nuk ka treguar shumë detaje për vendndodhjen e tij. Një zëdhënës ka deklaruar se Merz mbetet i gatshëm për të reaguar dhe po përdor pushimet edhe për t'u përgatitur për rikthimin e punës në shtator.

Sipas mediave gjermane, Merz ka marrë me vete gjatë pushimeve edhe një enciklikë të Papa Leo XIV për inteligjencën artificiale. Dokumenti paralajmëron për rreziqet e teknologjisë dhe kërkon që ajo të përdoret në shërbim të njerëzve.

Edhe në pushime, liderët evropianë nuk mund të shpëputen plotësisht nga politika. Luftërat, krizat dhe problemet e brendshme i detyrojnë ata të qëndrojnë në kontakt me qeveritë dhe ekipet e tyre, ndërsa çdo fotografi nga pushimet mund të kthehet lehtësisht në një çështje politike.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82



Shtyhet derbi ndërmjet Dritës dhe Prishtinës

PRISHTINË, 18 GUSHT - Derbi i xhiros së dytë të Superligës së Kosovës në futboll ndërmjet Dritës dhe Prishtinës nuk do të zhvillohet këtë javë. Përballja, e paraparë të zhvillohet në Gjilan, është shtyrë për një datë tjetër

për shkak të angazhimeve të Dritës në garat evropiane. Drita të enjten dhe javën e ardhshme do t'i zhvillojë dy ndeshjet e fazës "play-off" të Ligës së Konferencës dhe, për këtë arsye, nuk do të ketë

angazhime në Superligë. Ndërkohë, në kuadër të xhiros së dytë do të zhvillohen katër ndeshje të tjera. Xhiroja do të hapet të premten me duelin Malisheva - Drenica, ndërsa të shtunën do të zhvillohen

ndeshjet Dukagjini - Feronikeli '74 dhe Ballkani - Vushtrria. Të dielën është në program përballja Llapi - Gjilani. Të gjitha ndeshjet e xhiros së dytë të elitës së futbollit të Kosovës do të nisin nga ora 16:30.




MUÇOLLI I BASHKOHET LLAPIT NGA FUTBOLLI SKANDINAV

PODUJEVË, 18 GUSHT - Sulmuesi i krahut, Agon Muçolli, është përforcimi më i ri i Llapit. Skuadra e Superligës së Kosovës e ka paraqitur të martën Muçollin, i cili ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me klubin nga Podujeva. Muçolli vlerësohet si një përforcim i rëndësishëm për Llapin, duke marrë parasysh përvojën e tij në futbollin skandinav, ku ka luajtur në

Danimarkë, Norvegji dhe Suedi. "Me përvojë të madhe nga futbollit skandinav dhe përvojë në nivele të larta të futbollit profesionist, Muçolli vjen në Podujevë për ta veshur fanellën bardhekaltër dhe për t'i shtuar skuadrës sonë cilësi dhe forcë shtesë në repartin ofensiv", ka njoftuar Llapi. 27-vjeçari ka qenë pjesë edhe e Kombëtares U21 të Shqipërisë, ndërsa gjatë karrierës ka luajtur për

skuadra si Fredericia, Vejle, Odense, Kristiansund dhe Varbergs. Periudhën më të suksesshme e ka pasur te skuadra daneze Fredericia, me të cilën në 102 paraqitje ka shënuar 29 gola dhe ka regjistruar 22 asistime. Llapi e ka nisur sezonin e ri në elitën e futbollit të Kosovës me humbje 5:3 në udhëtim ndaj Dritës, ndërsa ndeshjen e radhës do ta zhvillojë këtë javë në shtëpi kundër Gjilanit.



RAMAJ HUAZOHET SËRISH TE COPENHAGENI

KOPENHAGË, 17 GUSHT - Portieri Diant Ramaj nuk do të jetë pjesë e Borussia Dortmundit për sezonin 2026/27, pasi është huazuar sërish te skuadra daneze e Copenhagenit. Ramaj është larguar nga klubi gjerman në formë huazimi,

ndërsa me Dortmundin ka kontratë deri në verën e vitit 2029. Huazimi i tij te Copenhageni tashmë është zyrtarizuar nga Dortmundi. Për 24-vjeçarin ky është rikthimi i dytë te skuadra elitare daneze, pasi edhe në



pjesën e dytë të sezonit 2024/25 ishte i huazuar te Copenhageni. Gjatë asaj periudhe Ramaj e ndihmoi skuadrën daneze të fitonte titullin e kampionit dhe Kupën. Sezonin e kaluar portieri ishte i huazuar te skuadra e

Bundesligës, Heidenheim, ndërsa huazimi te Copenhageni është i treti që prej transferimit të tij te Dortmundi. Ramaj iu bashkua Borussia Dortmundit në shkurt të vitit 2025 nga Ajaxi për shumën prej 7 milionë eurosh.

RISI NË PREMIERLIGË, TIFOZËT DO T'I DËGJOJNË KOMUNIKIMET MES FUTBOLLISTËVE DHE GJYQTARËVE

LONDËR, 18 GUSHT - Premierliga angleze do të sjellë një risi në sezonin 2026/27 sa i përket mënyrës së transmetimit të ndeshjeve, pasi tifozët do të kenë mundësi të dëgjojnë, në raste të caktuara, komunikimet mes futbollistëve dhe gjyqtarëve. Risia lidhet me zgjerimin e përdorimit të sistemit "RefCam", kamerës së vendosur në kokën e gjyqtarëve, e cila deri tani është përdorur kryesisht për pamje të



afërta dhe përsëritje të episodeve gjatë ndeshjeve.

Sipas rregullave të reja, transmetuesit që kanë të drejtat

televizive të Premierligës në Angli do të mund të publikojnë edhe pjesë të audios së regjistruar nga "RefCam" gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë. Megjithatë, përdorimi do të jetë i kufizuar. Për çdo ndeshje pritet të transmetohen vetëm një ose dy episode, ndërsa audioja nuk do t'i përfshijë komunikimet që lidhen me sistemin VAR. Kjo për shkak se publikimi i komunikimeve të VAR-it nuk lejohet nga rregullat e

përcaktuara nga IFAB. Fillimisht, eksperimenti me audion do të testohet përpara aplikimit të plotë në ndeshjet e kampionatit. Për këtë arsye risia nuk do të përdoret në fundjavën e parë të Premierligës për sezonin 2026/27. Në këtë mënyrë tifozët do të kenë një mundësi të re për të parë dhe dëgjuar nga një këndvështrim më i afërt atë që ndodh mes gjyqtarëve dhe futbollistëve gjatë ndeshjeve.

Muhamet Hyseni vazhdon karrierën në Rumani

BUKURESH, 18 GUSHT - Sulmuesi nga Kosova, Muhamet Hyseni, ka bërë një tjetër hap në karrierën e tij, duke u transferuar në elitën e futbollit rumun. Hyseni të martën është paraqitur te Farul Constanta, e cila ka arritur marrëveshje me Horsensin e Danimarkës për

transferimin e tij. Sulmuesi tashmë i është bashkuar skuadrës rumune, pasi ka kaluar me sukses testet mjekësore dhe ka nënshkruar kontratën. Gjatë prezantimit Hyseni ka thënë se është i lumtur që i është bashkuar Farul

Constantas dhe se shpreson të shënojë sa më shumë gola gjatë këtij sezoni. Sezonin e kaluar Hyseni ishte i huazuar te Llapi, ndërsa te Horsensi ishte transferuar pikërisht nga skuadra llapjane në vitin 2024. Në 32 paraqitje në Superligë ai ka shënuar 12 gola,

ndërsa në sezonin 2023/24 ishte shpallur golashënuesi më i mirë i kampionatit me 26 gola. Në Kosovë, Hyseni ka luajtur edhe për Malishevën dhe Feronikelin. Për Kombëtaren e Kosovës ai ka regjistruar dy paraqitje dhe ka shënuar një gol.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
National Audit Office

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURSIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 16.07.2026 për vendin e punës:

I. Pozita: Përkthyes (Shqip-anglisht dhe anasjelltas)


Numri i pozitave: Një (1)

Numri i referencës: PSA/ZKA/09-07/26

Konkursi anulohet bazuar në Rregulloren (ZKA) nr. 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Pristinë, 19.08.2026

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore



SAOPËSTENJE O PONIŠTENJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije saopštava da se poništava konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnoj veb stranici i na oglasnoj tabli NKR-a dana 16.7.2026. godine za sledeće radno mesto:

I. Pozicija: Prevodilac (Albanski-ingleski i obrnuto)

Broj pozicija: Jedna (1)

Broj reference: PSA/ZKA/09-07/26

Konkurs se poništava na osnovu Uredbe (NKR) br. 01/2024 o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije.

Priština, 19.8.2026.godine

Odeljenje za upravljanje ljudskim resursima





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANARDORËZUAR DATUM PRILAZA/POSTAVLJEN DATE RECEIVED/SUBMITTED			
Nivela Orig. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Classif. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. faqeve Br. Stranica No. Pages
07/2	112	1477	1

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURSIT


Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 19.05.2026 për vendin e punës:

I. Pozita: Zyrtar për Komunikim me Publikun
Numri i pozitave: Një (1)
Numri i referencës: RZKP/ZKA/12-15/25

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 1440 të Komisionit të Ankesave në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Prishtinë, 18.08.2026

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore



SAOPËSTENJE O PONIŠTAJU KONKURSA


Nacionalna kancelarija revizije saopštava da se poništava konkurs za sledeće radno mesto objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnoj veb stranici i na oglasnoj tabli Nacionalne kancelarije revizije dana 19.05.2026 godine:

I. Pozicija: Službenik za odnose s javnošću
Broj pozicija: Jedna (1)
Broj reference: RZKP/ZKA/12-15/25

Konkurs se poništava na osnovu Odluke br . 1440 Žalbene komisije Nacionalne kancelarije revizije.

Priština, 18.08.2026.goidne

Odeljenje za upravljanje ljudskim resursima



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Oriflame Cosmetics” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810523937 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Oriflame Cosmetics" L.L.C. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810523937 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Oriflame Cosmetics” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 810523937 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ariana Stuja shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 1.2. të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Erdonita Gjeka shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Besim Byci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Olti Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat kl. 10.11.12 si dhe diplomën e SH.M. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Epikao Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.
- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinierit i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të viltshme dhe po ashtu me çmim të viltshëm.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

